

# KOMUNA E KËRÇOVËS



## STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2024-2028

## Përmbajtja

Parathënie e Kryetarit .....	3
1. Përmbledhje ekzekutive .....	4
2. Lista e shkurtesave .....	5
3. Hyrje në strategji .....	6
4. Analizë ekonomike lokale.....	7
4.1. Analizë e strukturës ekonomike lokale .....	7
4.2. Bashkëpunim dhe ndërlidhje lokale.....	11
4.3. Mjedis biznesi, transparencë dhe administrim pa korrupsion.....	12
4.4. Qasje deri te financat .....	13
4.5. Tokë dhe infrastrukturë.....	14
4.6. Kornizë rregulative dhe institucionale.....	15
4.7. Aftësi, burime njerëzore, gjithëpërfshirje.....	17
4.8. Pozicionim i jashtëm dhe marketing.....	18
5. SWOT Analizë.....	20
6. Vizion dhe qëllime strategjike.....	22
7. Plan aksionar.....	28
8. Skema e financimit.....	29

## PARATHËNIE E KRYETARIT

Komuna e Kërçovës fokusohet në një cikël të ri të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik bazuar në një proces të detajuar të përshtatjes dhe miratimit të masave për përmirësimin e konkurrencës dhe mjedisit afarist.

Qëllimi ynë është të përmirësojmë konkurrencën e ekonomisë lokale duke promovuar klimën e biznesit, duke inkurajuar partneritetet rajonale dhe duke rritur investimet vendase dhe të huaja. Kërçova ofron një klimë të favorshme dhe të sigurt ekonomike dhe ka mundësi për investime në sektorë të ndryshëm.

Me këtë projekt bëhet përditësimi i një pjesë të të dhënave nga Strategjia e mëparshme për zhvillim lokal të ish-komunave: Drugovë, Vraneshticë, Zajas dhe Osllome deri në vitin 2009, por përcaktohen dhe planifikohen prioritetet që dalin nga nevojat bashkohore për zhvillim ekonomik.

Këtë strategji e kemi përgatitur me ndihmën e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar – USAID, përmes përfshirjes në projektin “Forcimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e burimeve”. Me këtë strategji të re, ne prezantojmë një qasje të re për rishikimin e strategjive të vjetra, duke përfshirë të gjithë aktorët relevantë në komunitete të cilët japin kontributin e tyre me aktivitete të reja dhe projekte reale për një pasqyrë më të mirë ekonomike për komunën.

Përmes implementimit të strategjisë do të realizohen një numër i madh projektesh në drejtim të përmirësimit dhe zhvillimit të ekonomisë lokale.

Fatmir Dehari  
Kryetar i Komunës së Kërçovës

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Kërçovës është një nga komunat e përfshira në grupin e bashkësive lokale në të cilat zbatohet projekti “Forcimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e resurseve”, nën mbikçyrjen e USAID-it, për të cilin është nënshkruar Memorandum Bashkëpunim nga të dyja palët në 2023. Një nga aktivitetet gjatë implementimit të këtij projekti është pikërisht mbështetja në përgatitjen apo përditësimin e Strategjive për zhvillimin ekonomik lokal.

Strategjia për ZHEL-in e Komunës së Kërçovës i referohet një periudhe katërvjeçare nga viti 2024 deri në vitin 2028 dhe është një dokument strategjik i pavarur që synon zhvillimin ekonomik lokal, përmirësimin e pasqyrës ekonomike në komunë dhe realizimin e projekteve reale që dalin nga të gjitha palët e interesuara si p.sh. sektori i biznesit, institucionet arsimore, sektori i shoqërisë civile, institucionet publike etj.

Për hartimin e Strategjisë ishte obliguar ekipi punues nga Njësia për zhvillim ekonomik lokal nga komuna e Kërçovës. Me kryetarin e „LESS,, me iniciativën e të cilit u mbajt një takim për nevojat e zhvillimit të strategjisë, duke përfshirë të gjithë aktorët: nga dhoma rajonale e tregtisë, sindikatat, organizatat e punëdhënësve, institucionet arsimore, sektori i shoqërisë civile, sektori i biznesit dhe të rinjtë, të cilët të gjithë morën pjesë aktive në përgatitjen cilësore, duke ofruar të dhëna përkatëse, duke dhënë kështu një pasqyrë të qartë të gjendjes së ekonomisë vendase, përmes së cilës mund të krijohet një vizion i progresit ekonomik, me të gjitha pikat e forta dhe të dobëta, si dhe mundësitë dhe kërcënimet. Gjithashtu janë vendosur kontakte me të gjitha institucionet që ofrojnë të dhëna përkatëse – Agjencia e Punësimit, Zyra e Statistikave, Regjistri Qendror, etj.

Në procesin e hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal, është bërë analiza e ekonomisë lokale dhe është përgatitur analiza SWOT e komunës, është përcaktuar vizioni, qëllimet strategjike nga të cilat ka dalë plani i veprimit me aktivitetet e propozuara. Vizioni që duam ta realizojmë do të realizohet përmes qëllimeve të përcaktuara strategjike që dalin nga gjendja reale, mundësitë dhe resurset që ofron Komuna e Kërçovës, plani aksionar me aktivitetet e propozuara, por sigurisht edhe nga analiza SWOT. Me këtë strategji do të përmirësohet planifikimi strategjik dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve, shoqatave dhe sektorit të biznesit, që nënkupton krijimin e mundësive për përmirësimin e parametrave ekonomikë në komunë, që do të nënkuptojë drejtpërdrejt përmirësimin e transparencës dhe krijimin e cilësisë më të mirë të kushteve të jetesës në komunë.

## 2. Lista e shkurtesave

ZHEL – Zhvillimi Ekonomik Lokal

DHRT – Dhoma Rajonale e Tregtisë

QZHPRJ – Qendra për Zhvillimin e Planit Rajonal Jugperëndimor

NVM – Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme

NJQV – Njësi të vetëqeverisjes lokale

OJQ – Organizata Joqeveritare

BE – Bashkimi Evropian

KESV – Këshilli Ekonomik Social Vendor

TI – Teknologjia e Informacionit

GDP – Prodhimi i Brendshëm Bruto

USAID – Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

APRMV – Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut

RQ – Regjistri Qendror

PPP – Partneritet Publik Privat

SEPP– Sistemi elektronik për prokurimin publik

PABZHR – Programi për asistencë në bujqësi dhe zhvillim rural

ZZHIT – Zonë e Zhvillimit Industrial Teknologjik

ESHS – Enti Shtetëror i Statistikave

PDU– Plani i detajuar urban

JKPC – Ndërmarrja publike Komunale Komunalec

GAL – Grupi aksional lokal

SWOT/SWOT – S-Strength dhe W-Weak dhe O-Opportunities dhe T-Threat

PBN - Programi për bashkëpunim ndërkufitar

BZHR – Byroja për Zhvillim Rajonal

AMFBZHR - Agjencia për mbështetjen financiare të bujqësisë dhe zhvillimit rural



### 3. Hyrje në strategji

Komuna e Kërçovës, shfaqti interes për projektin e USAID-it “Forcimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e resurseve”, ndërsa Memorandumi i bashkëpunimit është nënshkruar nga të dyja palët në vitin 2023.

Qyteti i Kërçovës ndodhet në Maqedoninë Perëndimore, në një distancë prej rreth 110 km nga kryeqyteti Shkupi. Për shkak të vendndodhjes së saj qendrore në pjesën perëndimore të Maqedonisë, Kërçova është një udhëkryq që të çon në katër drejtime. Qyteti lidhet me Shkupin me rrugën kryesore Kërçovë-Gostivar-Tetovë-Shkup. Drejtimi tjetër të çon në rajonin turistik Ohër-Strugë, drejtimi i tretë të çon në Manastirë, ndërsa i katërti për në Prilep. Komuna e Kërçovës është 54 km larg nga Aeroporti Sveti Apostol Pavle, Ohër dhe 139 km nga Aeroporti Aleksandri i Madh, Shkup. Portet më të afërta nga Komuna e Kërçovës janë Durrësi, Shqipëri me 222 km largësi, dhe porti i Selanikut, Greqi, me 272 km largësi. Përveç rrjetit rrugor, në Kërçovë është zhvilluar edhe një rrjet hekurudhor, i cili realizohet përmes linjës së hekurudhës Kërçovë-Gostivar-Tetovë-Shkup.

Sipas regjistrimit të fundit të kryer nga ESHS nga viti 2021, popullsia e përgjithshme rezidente është 39,669, nga të cilët 20,014 janë burra dhe 19,655 janë gra. Totali i popullsisë të aftë për punë janë 33.740, ndërsa popullësi aktive 15.680. Në gjithësej popullësi aktive-në marrdhënie pune 12.050, ndërsa në gjithësej popullsia aktive e papunë është 3,630. Popullsia totale joaktive është 17,217, ndërsa numri i përgjithshëm i panjohur është 843. (burimi: Enti Shtetëror i Statistikave - ESHS).

Rajoni i Kërçovës është i mbushur me resurse natyrore, të cilat paraqesin bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik: pyjet, kullotat, toka e punueshme, uji (burimi i Studençicës) si dhe hidropotenciali i lumenjve në rajon, resurset minerale (hekuri, linjiti, mangan dhe mermer), etj. Rajoni ka burime të pasura xehe hekuri. Shumica e tyre ndodhen pranë fshatit Tajmisht, i cili ka një minierë për shfrytëzim. REK Osllomej shfrytëzon resurset e linjitit kryesisht në atarin e fshatit Osllomej. Mali i Stogovës është i pasur me mangan, kurse mermeri më së shumti gjendet në lokalitetin e fshatit Cer, Miokazi, Bigor Dolenci.

Me këtë projekt të USAID-it dhe me strategjinë e komunës së Kërçovës, besojmë se administrata komunale do t'i forcojë dukshëm kapacitetet e saj, do të çojë në rritje të të hyrave nga burimet e veta, rritje të qasjes së financimit të jashtëm, rritje të nivelit të zbatimit të buxhetit të NJVL-së, dhe përmirësimi i klimës së biznesit, si dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik për një cilësi më të mirë jetese në komunitet.

## 4. Analiza e ekonomisë lokale

### 4.1 Анализа на локалната економска структура

Komuna e Kërçovës është njëra ndër komunat më të mëdha në rajonin e Jugperëndimor, sipas numërimit të fundit nga viti 2021, numri i përgjithshëm i popullsisë rezidente është 39.669 banorë nga të cilët burra janë 20.014, dhe 19.655 gra, që janë më pak nga përshkrimi i vitit 2001, ku numri i popullsisë arrin në 57.107 banorë. Për momentin tregu i punës në rajonin jugperëndimor është mesatarisht i pafavorshëm; Rajoni ka shkallën më të lartë të papunësisë (pas rajonit verilindor (33 për qind) dhe rajonit të Pollogut (28,5 për qind)) dhe shkallën më të lartë të punësimit (pas rajonit juglindor (63,3 për qind)) dhe shkallën e katërt më të lartë të aktivitetit krahasuar me shtatë rajonet tjera. Në vitin 2019 shkalla e papunësisë së popullsisë 15 vjeç e lart është 24,4 për qind (26,4 për qind për femrat dhe 23,1 për qind për meshkujt), shkalla e punësimit është 43,1 për qind dhe shkalla e aktivitetit është 57 për qind. Trendi mesatarisht i pafavorshëm reflektohet edhe në pagën mesatare bruto prej 33.099 denarë (Rajonet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ESHS, 2020). Shumica e të papunësuarëve janë nga mosha 30 deri në 50 vjeç (41 për qind), më pas vijnë të papunësuarit e moshës 50 vjeç e lart (33 për qind) (Grafiku 2). Pjesëmarrja relativisht e ulët e të rinjve në strukturën totale (26 për qind) ka të bëjë për faktin se 48 për qind e të papunësuarëve kanë pritur për punësim deri në një vit, shumica prej një deri në pesë muaj (burimi Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut).

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur kompanitë nga sektori privat në rajonin e Kërçovës. Mund të shohim se shumica e kompanive janë nga mikro dhe të vogla, ndërsa janë 11 kompani të mesme dhe vetëm 5 të mëdha.

<i>Lloji i aktivitetit ekonomik</i>	<i>Numri dhe % e kompanive (sipas klasifikimit)</i>			
	<i>Mikro</i>	<i>Të vogla</i>	<i>Të mesme</i>	<i>Të mëdha</i>
<b>Numri i kompanive</b>	<b>1637</b>	<b>469</b>	<b>11</b>	<b>5</b>
<i>Prodhim industrial</i>	83	3		
Bujqësi	25	9		
<i>Tregëti dhe prodhim</i>	609	151	8	4
<i>Shërbime biznesi (trajnim, konsulencë, hulumtim tregu, marketing, reklamë, botim, marrëdhënie me publikun)</i>	22	6		
<i>Veprimtari të përgjithshme të drejtorisë publike (komuna)</i>				1
<i>Shërbime financiare</i>	44	1		
<i>Shërbime mjekësore (spitale, praktikë mjekësore, stomatologji, farmaci)</i>	72	28	1	

Shërbime juridike (gjqësore, noterë, avokatë, përmbarues, përkthyes)	56	9		
Shërbime për popullatën (parukeri, riparime, instalime pajisjesh, lavanderi, suvatime, shërbime etj.)	260	17		
Restorante, kafene, bare etj.	95	9		
Hotele, hostele, etj.	4	2		
Arsim-Edukatë	5	13		
Organizime	104	124		
Aktivitete sportive, klube	33	35		
Shërbimet IT	12	1		
Transport	77	20		
Ndërtimtari	80	24		
Shërbime të komunikacionit	4	2		
Shërbime kreative (dizajn, fotografi, videografi, dizajn web, media sociale, radio, program televiziv)	22	2		
Menaxhimi i mbeturinave dhe furnizimi me ujë	4	1	2	
Turizëm	5			
Aktivitete kulturore (muze, ambiente për ngjarje kulturore, shoqëri arti, etj.)	9	12		
<b>Kompani në gjithësej në rajonin e Kërçovës</b>	<b>2122</b>			
<b>Filiale: 641 kompani</b>				
<i>*në territorin e komunës së Kërçovës ka gjithsej 641 subjekte juridike nga komunat tjera, por Regjistri Qendror nuk ka të dhëna se cilat nga këto subjekte juridike klasifikohen si ndërmarrje mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha.</i>				
<b>Në gjithësej më gjithë filiale</b>	<b>2763</b>			

Burimi i të dhënave për kompanitë në territorin e Kërçovës është nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut bazuar në të dhënat me të cilat disponon Regjistri Qendror



për të gjitha subjektet juridike dhe filialet në territorin e komunës së Kërçovës, si dhe personat juridikë nga komunat tjera që kanë filialë në rajonin e komunës së Kërçovës me të dhënat e tyre më 15.11.2023.

Kompania më efikase është në industrinë e automobilitave duke prodhuar pjesë dhe aksesore të tjerë për mjete motorike sipas fitimit dhe qarkullimit vjetor është Joyson Safety Systems, një lider botëror për projektimin, zhvillimin dhe prodhimin e komponentëve dhe sistemeve kritike për sigurinë e automobilitave, duke përfshirë mekanizmat e fryrjes, jastëkët e ajrit, timonin dhe rripat e sigurimit. Produktet e JSS janë pjesë e më shumë se 300 modeleve të makinave të prodhuara nga më shumë se 60 klientë me diverzitet të lartë në mbarë botën. JSS me seli është në Michigan, SHBA me një rrjet ndërkombëtar prej 29 objektsh shitjeje, projektimi dhe prodhimi që punësojnë rreth 9,000 njerëz në mbarë botën. Kompania ka 5 qendra kryesore teknike të licencuara në SHBA, Gjermani, Kinë, Japoni dhe Korenë e Jugut. Kompania Joyson Safety Systems është një nga kompanitë më të suksesshme në Maqedoni në prodhimin e pjesëve për automobila. Kompania në fushën e prodhimit dhe tregtisë, ndërtimitarisë dhe aktivitetit shërbyes është Atva Group zingjiri i marketeve, restoranteve, Shoqëria tregtare për prodhim tregti dhe shërbime INSTALIMI import-eksport Ismail SHPKNJP f.Dllapkin Doll Zajas, AS Senjak, Lindi etj. Duke parë sektorët, mund të konstatojmë se sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicionim është në rritje, ai bankar dhe ai mjekësor, si dhe sektori i ndërtimit është në rritje për shkak se po ndërtohen ndërtesa të reja banimi, infrastruktura rrugore e tj. Ndërsa rënie vijojnë në industrinë përpunuese dhe në bujqësi.

Sipas të dhënave përfundimtare të Entit Shtetëror të Statistikës, në vitin 2021, rajoni i Shkupit ka pjesëmarrjen më të madhe në bruto-prodiktin vendor të Republikës së Maqedonisë së Veriut me 44,1%, ndërsa rajoni Verilindor me pjesëmarrjen më të vogël me 4,8%.

Bruto-prodhim më të madh vendor për banorë, në krahasim me mesataren e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka rajoni i Shkupit me indeks 133.4, Rajoni Jug Lindor me indeks 105.5 dhe Rajoni i Vardarit me indeks 103.4, dhe Rajoni Lindor me indeks 101.4. Të gjitha rajonet e tjera kanë një prodhim të brendshëm bruto nën mesataren e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Komuna e Kërçovës është në rajonin planor jugperëndimor dhe sipas të dhënave të Entit shtetëror për statistikë në vitin 2021, BPV në këtë rajon është 63.294 në milion denarë, ndërsa BPV për banor është 356.791 e shprehur në denarë, ndërsa struktura e BPV-së është 8.7, dhe Prodhimi i Brendshëm Bruto për banor MK = 100 është 89.8. Sa i përket investimeve bruto në mjete themelore sipas rajoneve, në vitin 2021, në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë realizuar 171.094 milionë denarë investime në mjete themelore, që është 17,1% më shumë se në vitin 2020. Rajoni i Shkupit vazhdon të ketë pjesëmarrjen më të madhe në gjithsej investimet bruto në mjete themelore në vitin 2021 me 55.7%, ndërsa rajoni verilindor me pjesëmarrjen më të vogël me 4.3%.

Krahasuar me vitin 2020, rritje e investimeve në mjete themelore është vërejtur në rajonin e Pollogut (40,5%), Rajonin e Pellagonisë (39,4%), Rajonin e Shkupit (28,3%), Rajonin Juglindor (12,0%) dhe Rajonin Verilindor (9,5%). Zvogëlim në investimet e mjeteve themelore janë regjistruar në rajonin Jugperëndimor (22.0%), në rajonin e Vardarit (12.9%) dhe në rajonin Lindor (1.0%).

Në tremujorin e dytë të vitit 2023, rritje më e madhe është vërejtur në sektorët E, ZH dhe Z - Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave; Transporti dhe magazinimi; Objektet akomoduese dhe aktivitetet e shërbimit ushqimor nga 7.6% dhe Aktivitetet financiare dhe aktivitetet e sigurimit nga 5.0%. Konsumi final i familjeve, përfshirë institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë familjeve, në tremujorin e dytë të vitit 2023 rritet nominalisht me 9.9%, dhe pesha e tij në strukturën e prodhimit të brendshëm bruto është 73.9%. Në të njëjtën periudhë, eksporti i mallrave dhe shërbimeve u rrit nominalisht me 2.6%, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rënie nominale prej 3.0%.

<b>T-01: Prodhimi i brendshëm bruto sipas rajonit, 2021</b>					
<b>T-01: Gross domestic product, by regions, 2021</b>					
	Prodhimi i brendshëm bruto (në miliona denarë)	Produkti i brendshëm bruto për banor (në denarë)	Struktura e produktit të brendshëm bruto	Produkti i brendshëm bruto për banor MK = 100	
<b>Republika e Maqedonisë së Veriut</b>	<b>729 445</b>	<b>397 147</b>	<b>100,0</b>	<b>100,0</b>	<b>Republic of North Macedonia</b>
I Vardarit	56 947	410 511	7,8	103,4	Vardar
Lindor	60 522	402 853	8,3	101,4	East
Jugperëndimor	63 294	356 791	8,7	89,8	Southwest
Juglindor	62 201	419 181	8,5	105,5	Southeast
I Pellagonisë	76 596	363 995	10,5	91,7	Pelagonia
I Pollogut	53 139	211 245	7,3	53,2	Polog
Verilindor	35 053	229 134	4,8	57,7	Northeast
I Shkupit	321 692	529 964	44,1	133,4	Skopje

\*Burimi-DSHS e RMV

## 1.1 Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi lokal

Me qëllim të përmirësimit të klimës së biznesit në nivel lokal si dhe përmirësimit të komunikimit me sektorin privat në Komunën e Kërçovës, është themeluar Këshilli Lokal Ekonomik Social, në të cilin Komuna e Kërçovës, Këshilli I Sindikatave, Organizata e Punëdhënësve, Oda Rajonale e Biznesit të Kërçovës, përfaqësues të „AVRM,, qendra për çështje sociale, institucionet arsimore, institucionet publike, këshilli rinor dhe palë të tjera të interesuara. Qëllimi i këtij organi këshillimor është të inkurajojë bashkëpunimin për çështje strategjike për zhvillimin ekonomik lokal dhe të qëndrueshëm të komunës, përcaktimin e prioriteteve zhvillimore dhe strukturore, tërheqjen e kapitalit vendas dhe të huaj, udhëzimet për zhvillimin e politikave ekonomike lokale dhe mjedisin e favorshëm për zhvillimin e biznesit, përmirësimin e fluksit të informacionit, shërbimet për bizneset si dhe disa procedura administrative, duke krijuar partneritete me subjekte rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Këshilli lokal ekonomik dhe social i Komunës së Kërçovës i shqyrton çështjet, I jep mendime, propozime dhe rekomandime Këshillit të Komunës dhe autoriteteve tjera.

Kryetari dhe administrata komunale rregullisht mbajnë takime me qytetarë, shoqata civile dhe ekonomi me qëllim të përmirësimit të shërbimeve komunale, përmirësimit të kushteve për të bërë biznes, si dhe imazhin e komunës si vend i përshtatshëm për të bërë biznes dhe jetesë kualitative. Takimet me sektorin e biznesit zhvillohen individualisht dhe shpesh me kërkesë të vetë bizneseve.

Për komunat Kërçovë, Plasnicë dhe Makedonski Brod është formuar „LAG,, "Terska", me përfaqësues të cilët mbështesin zhvillimin rural të territorit të komunave që e formojnë këtë „LAG,,.

Kemi bashkëpunim të shkëlqyeshëm me Qendrën për Zhvillim Rajonal të Rajonit Planor Jugperëndimor, ku përfaqësuesit tanë nga njësia për ZHEL marrin pjesë në zhvillimin e programit, dosjet e projekteve dhe zbatimin e projekteve nga Byroja për Zhvillim të Balancuar.

Gjithashtu, komuna e Kërçovës merr pjesë aktive në bashkëpunimin ndërkombëtar, rajonal dhe ndërkomunal. Në IPA, bashkëpunimi ndërkufitar me komunat nga Greqia dhe zbatimi i përbashkët i projekteve, si dhe përfshirja e sektorit të biznesit për promovimin dhe mundësitë e produkteve vendore dhe bashkëpunimin e tyre, është përgaditur një udhëzues për investime, pjesëmarrje në Panair. . Ne gjithashtu marrim pjesë në programin Balkan MED dhe zbatimin e një projekti për bashkëpunim ndërkufitar me disa vende dhe trajnime për sipërmarrje dhe startup për të rinjtë në kuadër të projektit.

Komuna ndërlidhet me komuna të tjera, institucione dhe subjekte të tjera për realizimin e projekteve të ndryshme. Përkrahja e „MSP,, -ve dhe OJQ-ve përmes programit për zhvillim nga NJVL nga ana e Komunës së Kërçovës dhe vendosjen në funksion të Odës Ekonomike Rajonale

në Kërçovë me të cilën është nënshkruar Memorandumi për bashkëpunim, përkrahje dhe implementim të projekteve.

Pikën e dobët e kemi gjetur në mungesën e iniciativave për thirrjen e seancave të organeve ekzistuese dhe ruajtjen e vazhdimësisë së punës së tyre, numrin e pamjaftueshëm të takimeve të organizuara ndërmjet sektorit të biznesit dhe kryetarit të komunës dhe mbajtjen e takimeve të rregullta dhe performancën e dobët të sektorit të biznesit nga ekonomia lokale dhe iniciativën për bashkëpunim me komunën dhe institucionet tjera në realizimin e projekteve.

#### **4.3 Mjedi i biznesit, transparenca dhe administrimi pa korrupsion**

Vetëqeverisja lokale, kryetari, këshilltarët, shërbimet eksperte në punën e tyre të përditshme vendosin kontakte të rregullta me qytetarët, organizatat qytetare dhe ekonominë, llogaridhënia dhe transparenca praktikohet përmes informimit të mediave elektronike dhe rrjeteve sociale dhe mbajtjes së seancave të hapura të Këshillit ndaj publikut. Seancat e Këshillit janë të hapura për publikun, kurse rendi i ditëve, procesverbalet dhe vendimet e dala nga këto seanca janë të vendosura në web faqen e komunës. Në rrjetet sociale publikohen informacione lidhur me rendin e ditës dhe vendimet nga i njëjti. Të gjitha procedurat e tenderit të organizuara nga administrata komunale janë të publikuara në sistemin elektronik për shpallje publike (<https://e-nabavki.gov.mk/>) dhe çdo palë e interesuar mund të marrë pjesë në hapjen e ofertave. Gjithashtu, të gjitha aktivitetet e planifikuara, shpalljet, kontratat e lidhura dhe të realizuara janë të publikuara në web faqen e komunës, ndërsa kompanitë e interesuara mund të marrin informacion për tenderët e publikuar nga zyrtarët përkatës.

Për sa i përket transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, komuna publikon rregullisht raportet e saj financiare, buxhetin, llogaritë përfundimtare, shpalljet publike, planet vjetore, njoftimet për prezantime publike dhe anketa publike në faqen e internetit të komunës në mënyrë që të gjitha informatat relevante të jenë në dispozicion të sektorit privat si dhe palët e tjera të interesuara në shoqëri.

Si pikë e dobët në Komunën e Kërçovës është se duhet të krijohet një ekstrakt elektronik për më shumë informata dhe për përmirësimin e komunikimit me biznesmenët dhe informimin në kohë. Mungesa e një programi për sipërmarrësit e bazuar në një analizë të duhur të nevojave në komunitet, dhe mbështetje financiare për themelimin dhe fillimin e një biznesi të ri dhe hapjen e një kompanie dhe trajnimin e punëdhënësve të rinj. Iniciativa të pamjaftueshme nga biznesi për bashkëpunim me komunën dhe institucionet tjera relevante për realizimin e projekteve. Informacioni për programet kombëtare apo programet e donatorëve për të mbështetur biznesin është i parregullt dhe nuk mund të gjendet në faqen e internetit të komunës. Informacion i pamjaftueshëm në web faqen e internetit dhe informacion i vjetëruar për ofrimin e më shumë informacioneve për biznesin dhe mbështetjen e tij. Interesi i dobët për investime tek të rinjtë,

kapaciteti i dobët për të përdorur subvencionet dhe masat tek të moshuarit në zonat rurale. Informacion në lidhje me programet ndërkombëtare dhe kombëtare dhe bashkëpunimin dhe promovimin nga agjencitë dhe shoqatat.

#### **4.4 Qasja në financa**

Komuna e Kërçovës ka fond komunal të grantuar për mbështetjen e startup-eve përmes Programit për Mbështetjen e Zhvillimit Ekonomik Lokal, i dedikuar për personat e papunë deri në 48 vjeç që dëshirojnë të hapin një biznes fillestar dhe për kompanitë dhe personat e papunë, tek të cilët subvencionohet një punë e re në kompani ekzistuese.

Në komunën e Kërçovës nuk ekziston një bazë e vetme qendrore e informimit të plotë për ofertën momentale të burimeve të financimit për bizneset e vogla dhe të mesme, dhe aktualisht ato janë të kufizuara dhe të pamjaftueshme. Në interes të zhvillimit të komunitetit të biznesit, si mënyra të shfrytëzimit të fondeve, renditen disa nga mundësitë e disponueshme: Fondet evropiane dhe Programet evropiane, ERAZMUS+, HORIZONT EUROPA, COSME, PROGRESS +, Life +, Programi IPA, INTEREG, Programi Zhvillimor i Kombeve të Bashkuara - UNDP, Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ, SWG - Grupi i Përhershëm Punues për Zhvillimin Rajonal Rural në Evropën Juglindore, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID përmes një numri të madh programesh, masash dhe projektesh, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).


Sa i përket bankave në rajonin e komunës kemi: Komercijalna Banka, NLB Banka, Stopanska Banka, TTK Banka, Uni Banka, Halkbank, Sparkase, ndërsa nga bankat dhe fondet ndërkombëtare janë: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, WEBSEFF – Institucioni I qëndrueshëm për financimin e Ballkanit Perëndimor, GEF Kredite për financimin e ekonomisë së gjelbër, Banka Evropiane e Investimeve – EIB, Banka Botërore. Kjo tregon se oferta aktuale e bankave në komunën e Kërçovës mundëson qasje në burime financiare për një gamë të gjerë aktiviteteve, dhe shuma maksimale e ofruar nga bankat është solide, por nuk ka mbështetje lokale për qasje në burime financiare në formën e një subvencionit për pjesëmarrje në kredi ose në skemën e garancisë komunale.

Programet kombëtare për mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përfaqësohen përmes aktiviteteve të ndryshme: konkurrencë, inovacion, sipërmarrje, bujqësi dhe zhvillim rural, e të tjera. Këto realizohen kryesisht përmes thirrjeve publike të: Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, Ligjit për Mbështetjen Financiare të Investimeve, Agjencisë për Promovimin dhe Mbështetjen e Turizmit, Fondit për Inovacion dhe Zhvillim Teknologjik, Agjencinë për Mbështetjen Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Programi i Vetëpunësimit, Banka e Zhvillimit dhe banka të tjera.

Ajo që është e rëndësishme që komuna të bëjë në periudhën e ardhshme është të sigurojë akses në të gjitha informacionet për shfrytëzimin e mundësive financiare për subjektet e interesuara, të rrisë komunikimin me komunitetin e biznesit dhe të ofrojë mbështetjen e saj këshillimore në rastet kur është e nevojshme.

#### 4.5 Toka dhe infrastruktura

Rrethi I Kërçovës ka 12.251 ha tokë, 6.923 ha tokë arë dhe fusha, 78 ha pemishte, 10 ha vreshta, 4.540 ha livadhe, 15.151 ha kullota. Sipërfaqja pyjore është 51346 ha dhe është rajoni më i pasur në Maqedoni.



Zona industriale ne zonen e IVANI DOL, e vene ne funksionim per nje ekonomi te vogel, jane ndertuar objekte dhe funksionojne rreth 20 kompani ("Tim Engineering" LLC, "Euro-Fix" SH.P., "Nora Company", "Dar Hris" SHPKNJP dhe të tjerë.) dhe nuk ka vend për t'u zgjeruar.

TIRZ - zonë e ndërtuar në të cilën JSS operon për prodhimin e airbagëve. Një investim i ri në TIRZ është lajmëruar për gjysmën e parë të 2024 për prodhimin e baterive, të cilat do të thithin punësime të reja.

TIRZ Kërçovë ka dy sipërfaqe: Sipërfaqja 1 përbëhet nga tre blloqe me sipërfaqe 135.000 m<sup>2</sup> (Blloku 1 – 18592 m<sup>2</sup> Një parcelë ndërtimore 9000 m<sup>2</sup>, Blloku 2 – 20174 m<sup>2</sup>, Dy parcela me sipërfaqe prej 11600 m<sup>2</sup>, Blloku 3 – 96210 m<sup>2</sup>, Gjashtë parcela ndërtimi në një sipërfaqe prej 62175 m<sup>2</sup>) dhe Sipërfaqja 2 përbëhet nga katër blloqe në një sipërfaqe prej 160,600 m<sup>2</sup> Blloku 1 – 16464 m<sup>2</sup>, Dy parcela ndërtimi në sipërfaqe 10000 m<sup>2</sup>, Blloku 2 – 28761 m<sup>2</sup>, Një parcelë



ndërtimi 12365 m2 dhe Blloku 3 – 57979 m2, Dy parcela ndërtimi në sipërfaqe 37300 m2 dhe Blloku 4 – 36496 m2, Dy parcela ndërtimi në një sipërfaqe prej 36495 m2.

Komuna si institucion ka një ndërtesë të re komunale, hapësirat e vjetra do të mund të përdoren si inkubator biznesi, nëse ka interes për të, ose do t'u ndahen OJQ-ve, institucioneve publike etj. Oda ekonomike rajonale dhe disa shoqata tashmë përdorin objektet komunale për punën e tyre. Komuna ka edhe një qendër multimediale për shfrytëzimin e Sektorit të Biznesit, OJQ-ve etj., për ngjarje publike, trajnime, manifestime etj.

Si pikë e dobët është se nuk ka hapësirë të re për një zonë të vogël ekonomike sipas nevojave të të kthyerve që janë të interesuar për investime dhe hapësira/zyra të pamjaftueshme dhe një ide për t'i vënë ato në një funksion që do të sjellë përfitim.

#### **4.6 Kuadri rregullator dhe institucional**

Problemet më të mëdha për të cilat sektori i biznesit ankohet në kuadrin rregullator dhe institucional lidhen me proceset e gjata burokratike dhe barrierat administrative që pengojnë veprimin e shpejtë dhe në kohë. Ata theksojnë mungesën e shërbimeve të dixhitalizuara në të gjitha institucionet si një nga problemet serioze.

Problemi me procedurat në institucione është diçka që ekziston prej kohësh dhe ende nuk është zgjidhur, edhe pse po bëhen përpjekje që këto procedura të lehtësohen. Gjithashtu, mosbesimi që banorët dhe veçanërisht sektori i biznesit privat kanë ndaj institucioneve është diçka që e aktualizon këtë problem dhe krijon barriera shtesë.

Sfidat ekzistuese rregullatore (sipas sektorit privat)	Ndikim negativ i madh/ i vogël	Institucioni i madh publik i përfshirë	Përshkrimi i fushës së zgjidhjes së problemeve lokale (detaje)
<p>Procedurat e ngadalta për marrjen e miratimeve për ndërtim, veçanërisht nëse varen nga miratimet e institucioneve të tjera të përfshira, si dhe procedurat e ngadalta për marrjen e miratimeve për ndryshimin e planeve urbanistike.</p>	<p><i>E madhe</i></p>	<p><i>Komuna e Kërçovës</i></p> <p><i>Ministria e mjedisit jetësorë, sektori i kullotave,</i></p> <p><i>Drejtoria për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore</i></p>	<p><i>Përshpejtimi i procedurave për marrjen e miratimit për ndërtim ose marrjen e miratimeve gjatë realizimit të projekteve në të cilat kërkohen miratimet nga institucionet apo administratat përkatëse, si dhe modifikimi dhe shtimi i planeve, nëpërmjet dixhitalizimit dhe futjes së mjeteve dhe aplikimeve të përshtatshme nga institucionet e lartëpërmendura.</i></p>
<p>Procedura e ngadaltë dhe shkuarja personalisht në institucione të caktuara për plotësimin e lëndëve.</p>	<p><i>E madhe</i></p>	<p><i>Ministria e Mjedisit, - sektori i kullotave</i></p> <p><i>Administrata për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore etj.</i></p> <p><i>Komuna e Kërçovës</i></p>	<p><i>Ata theksojnë mungesën e shërbimeve të dixhitalizuara në të gjitha institucionet si një nga problemet serioze</i></p>
<p>Edhe pse komuna ka krijuar një qendër komunale për shërbim, lëvizja e dokumenteve ndërmjet njësive bëhet në formë të shtypur dhe jo në formë elektronike.</p>	<p><i>E vogël</i></p>	<p><i>Komuna e Kërçovës</i></p>	<p><i>Dixhitalizimi – aplikimi i duhur i aplikacionit ekzistues ose instalimi i një të riu sipas nevojave, me qëllim marrjen e shpejtë të dokumentacionit të nevojshëm në dobi të palëve.</i></p>
<p>Mundësia e uljes së taksave dhe tatimeve vendore, për bizneset fillestare, që mund të vendoset nga këshilli komunal</p>	<p><i>E vogël</i></p>	<p><i>Komuna e Kërçovës</i></p>	<p><i>Marrja e vendimit nga Këshilli i Komunës së Kërçovës në përputhje me rregulloret ekzistuese ligjore</i></p>

Në këtë drejtim, sektori i biznesit sugjeron një koordinim më të mirë me institucionet përkatëse kompetente.

#### **4.7 Aftësitë, burimet njerëzore, inkluzivitet**

Komuna e Kërçovës ka përgatitur një analizë të tregut të punës, sipas së cilës ka mungesë të hapjes së vendeve të punës, kualifikime më të ulëta dhe mungesë të fuqisë punëtore me shkathtësi të mesme. Në rajonin jugperëndimor, komuna e Kërçovës, për çdo punëtor me arsim fillor janë 11 të papunë, për arsimin e mesëm dhe të lartë ky raport është 1.2, ndërsa për arsimin e lartë 7.5. Oferta më e madhe se kërkesa ka në profesionet me aftësi të larta: ekspertë juridikë e socialë dhe ekspertë nga fusha e kulturës. Në të gjitha profesionet e tjera, ku shfaqen boshllëqe, ato zhduken ose shndërrohen në deficitare me rritjen e arsimit. Kjo tregon se profesionet janë të përshtatshme, por nevojitet kualifikim i mëtejshëm. Institucionet arsimore në komunën e Kërçovës kanë nevojë për një ristrukturim të konsiderueshëm për të adresuar zbrazëtitrat në profesionet deficitare, dhe disa prej tyre janë thelluar më tej në suficit me prodhim intensiv dhe masiv të profileve të suficitit.

Është evidentuar nevoja që institucionet arsimore, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës, të punojnë në ndryshimin e programeve dhe profileve arsimore dhe në ngritjen e programeve me profesione në deficit, të përshtatshme për nevojat e tregut të punës dhe t'i përkushtohen vazhdimisht duke rritur atraktivitetin dhe kuotat për ta. Duhet veprim i sinkronizuar ndërmjet Qendrave të Kualifikimit dhe Rikualifikimit, AVRSM, Qendrës së Punësimit, Komunitetit të Biznesit dhe komunës, në zhvillimin dhe zbatimin e një Plan Aksioni gjithëpërfshirës të saktë, i cili do të jetë efektiv dhe efikas me indikatorë të matshëm.

Fushat e mundshme të veprimit janë ngritja e kapaciteteve dhe trajnimi në sektorin e biznesit, një diskutim më i gjerë ndërmjet sektorit të biznesit, institucioneve arsimore, komunës, sektorit joqeveritar dhe institucioneve të tjera publike për aftësitë dhe kërkesat e nevojshme të tregut të punës, më shumë dhe bashkëpunimi i koordinuar me shkollat e mesme dhe fakultetet përkatëse, futja e arsimit të dyfishtë në shkollat e mesme, organizimi i kurseve dhe trajnimeve të përshtatshme, krijimi i kushteve të punës në komunë për markat e njohura të IT-së që ofrojnë shërbime të mira, subvencionimi i të rinjve që ofrojnë shërbime të IT-së. Fuqizimi i bashkëpunimit në mes të shkollave të mesme profesionale me sektorin e biznesit, veçanërisht me investitorët e huaj në komunën e Kërçovës, duke përfshirë një pilot projekt për arsim të dyfishtë në dy deri në tre profesione (në përputhje me strategjinë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës). Rishikimi i programeve/drejttimeve dhe shkathtësive të ofruara nga diploma e fituar në përputhje me profesionet e kërkuara në tregun e punës të komunës së Kërçovës dhe sipas aftësive të kërkuara (p.sh., shkathtësitë lidhur me shkencat STEM, aftësitë analitike, të menduarit kritik , etj.). Këshillim dhe orientim për karrierë të të rinjve në zgjedhjen e një profesioni bazuar në nevojat e tregut të punës.

Në Komunën e Kërçovës ekzistojnë tre çerdhe, nëntë shkolla fillore, dy shkolla të mesme dhe tri institucione të arsimit të lartë: Universiteti i Punës "Krste Petkov Misirkov", Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Teknik Teknologjik.

Si pikë e dobët, theksohet se nuk ka koordinim mes komunës, komunitetit të biznesit, institucioneve arsimore dhe trajnuese. Disa biznese iniciojnë trajnime vetëm për nevojat e tyre, por jo së bashku me biznese të tjera nga i njëjti sektor. Arsimi profesional i kërkuar nga tregu i punës: punë e pakualifikuar, staf pak i disponueshëm, (inxhinierë, arkitektë) si administrativë ashtu edhe punëtorë, mungesa e fuqisë punëtore cilësore, kamerierë, banakierë, kuzhinierë, për shkak të migrimit në vende të tjera për paga më të mira, veçanërisht në Kroaci gjatë periudhës së verës.

#### **4.8 Pozicionimi i jashtëm dhe marketingu**

Komuna e Kërçovës ka një pozicion qendror në pjesën jugperëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me një infrastrukturë të zhvilluar rrugore dhe hekurudhore, pranë dy aeroporteve dhe më pak se 3 orë larg porteve të Durrësit dhe Selanikut. Rajoni i Kërçovës është i mbushur me resurse natyrore, të cilat paraqesin bazën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik: pyjet, kullotat, toka e punueshme, uji (burimi i Studençicës) si dhe hidropotenciali i lumenjve në rajon, resurset minerale (hekuri, linjiti, mangan dhe mermer), etj. Rajoni ka burime të pasura xehe hekuri. Pjesa më e madhe e tyre ndodhen pranë fshatit Tajmisht, ku ka një minierë për shfrytëzim. REK Oslomej shfrytëzon resurset e linjiti kryesisht në atarin e fshatit Oslome. Mali i Stogovës është i pasur me mangan, kurse mermeri më së shumti gjendet në lokalitetin e fshatit Cer, Miokazi, Bigor Dolenci.

Në komunën e Kërçovës është ndërtuar një hidrocentral i vogël. Ai është menduar për furnizimin me ujë të më shumë se 160,000 banorëve dhe pritet të prodhojë 2.5 GWh energji elektrike në vit. Rrethina e Kërçovës ka 12251 ha sipërfaqe tokë, 6923 ha fush, 78 ha pemëtores, 10 ha vreshta, 4540 ha livadhe, 15151 ha kullota. Bujqësia, duke përfshirë blegtorinë, peshkimin, gjuetinë, bletarinë dhe pylltarinë, është sektori i tretë më i madh me një peshë në BPV, në raport me shërbimet dhe industrinë.

Në zonën e rrethinës së Kërçovës gjenden monumente jashtëzakonisht të vlefshme nga kultura materiale që kujtojnë të kaluarën dhe krijojnë kushte për ngritjen e ofertës turistike në një nivel më të lartë.

Ndër to veçojmë: kalanë e Kitino Kalasë, e cila është vend arkeologjik, tempulli i "Shën Pjetrit dhe Palit", manastiri "Sveta Bogorodica Preçista", i cili daton nga viti 1316 dhe është tempull për të gjithë besimtarët, manastiri "Shën Gjorgjija", egzistojnë më shumë objekte fetare myslimane – teqe dhe xhamitë e rrethinës së Kërçovës, muzeu i Maqedonisë Perëndimore dhe një sërë manifestimesh të tjera kulturore, festivale ndërkombëtare, koncerte, koloni artistike,

shfaqje teatrore etj. Në fshatin Vraneshticë gjendet hisopi prej balte dhe është një nga fshatrat më të njohur në vend për prodhimin e enëve prej balte. Aty prej më shumë se 1000 vitesh janë bërë enë nga balta, për të cilën banorët e fshatit thonë se janë disa prej tyre. Sipërfaqja pyjore është 51346 ha dhe është rajoni më i pasur në Maqedoni. Ky është parakusht për zhvillimin e madh të pylltarisë dhe industrisë së drurit dhe parakusht i madh për zhvillimin e gjuetisë në rrethinën e Kërçovës, si dhe të bletarisë. Mbi pesëdhjetë prodhues të mjaltit prodhojnë një gamë të pasur produktesh dhe preparatesh të bletëve me bazë mjaltin. Rrethina e Kërçovës është relativisht e pasur me ujëra dhe rrjedha të shumta lumore: I Treskës, i Studençicës, i Belicës, i Tuhinit, i Ehlloecit, i Cerskës, i Rabetinës, i Baçishtit, i Tajmishtit dhe I Greshnicës.

Komuna investon në realizimin e infrastrukturës së re ose rikonstruimin e infrastrukturës ekzistuese - parku i Kitino Kalasë, gjimnaze, shkolla, ambiente dhe salla sportive, godina e re komunale etj.

Komuna perceptohet nga banorët e saj në këto aktivitete: nuk ka masa të dallueshme për mbështetjen e komunitetit të biznesit, përmirësimin e mjedisit të biznesit si dhe cilësisë së jetesës, veçanërisht në aspektin e ngjarjeve kulturore dhe objekteve shëndetësore, megjithëse nuk janë nën kompetencë të komunës si institucion, prandaj nuk ka cilësi të jetës në aspektin e ngjarjeve apo përmbajtjeve që do të tërhiqnin vizitorët vendas dhe të huaj, nuk ka synime të përcaktuara qartë për mërgimtarët që duan të investojnë, pastërtia publike dhe kujdesi për mjedisin është në nivel të ulët, dhe promovimi i dobët i mundësive alternative për investime në turizëm, promovimi i dobët i produkteve vendore - pa program dhe strategji për turizmin, pa vende qartësisht të dukshme dhe të shënuara për të vizituar vende dhe lokalitete të rëndësishme.

Si pikë e dobët është promovimi i pamjaftueshëm i turizmit - nuk ka një strategji të përcaktuar për zhvillimin e turizmit me të gjithë komponentët e tij dhe rrjetëzimin e aktorëve të ndryshëm, veçanërisht të emigrantëve, për investimin e tyre në projekte të natyrës nga më të ndryshmet.

## 5. SWOT Analiza

Analiza SWOT është një metodë e planifikimit strategjik që përdoret për të vlerësuar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e përfshira në një projekt ose biznes. Ai përfshin përcaktimin e objektivit të sipërmarrjes ose projektit të biznesit dhe identifikimin e faktorëve të brendshëm ose të jashtëm, të favorshëm ose të pafavorshëm, për të arritur objektivin.

Më poshtë në tabelë është analiza SWOT e komunës së Kërçovës:

ANËT E FUQISHME	ANËT E DOBËTA
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vendndodhja e mirë gjeografike për sa i përket lidhjes infrastrukturore (rrugë, linja aeroplani, hekurudha, etj.)</li> <li>• Pasuritë natyrore, lumenjtë, pyjet dhe kullotat, Komuna e Kërçovës është komuna më e pasur me pylltari në vend - Rajoni i Kërçovës me sipërfaqe pyjore prej 51346 ha është më i pasuri në R. e Maqedonisë 2895 ha prej tyre janë në pronësi private. NP "Pyjet e Maqedonisë", filiala „SHS,, "Llopushnik"-Kërçovë posedon 48451 ha. Llojet më përfaqësuese janë ahu dhe dushku.</li> <li>• Dhoma Rajonale e Biznesit, aktive dhe funksionale me anëtarë aktivë të interesuar për bashkëpunim dhe zhvillim</li> <li>• Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore, Kitino Kalaja, Manastiri „Preçista Bogodorica,, Xhamia e Sulltan Bajazit, Muzeu i Maqedonisë Perëndimore në „NOV,, shkolla e parë në gjuhën maqedonase në fshatin Podvis, etj.</li> <li>• Stacioni i trajtimit të ujit, i cili përfshin edhe TIRZ-in si zonë industriale</li> <li>• Kushtet për investime në Zonën Industriale të Ekonomisë së Vogël, në parcelat e mbetura</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dalja e stafit profesional, veçanërisht nga sektori i IT dhe industria e hotelerisë, në dy vitet e fundit në Gjermani dhe Kroaci.</li> <li>• Përqindje e lartë e migrimit të të rinjve, 48% sipas treguesve dhe hulumtimeve në pajtim me censusin e fundit.</li> <li>• Ndikim, veçanërisht nga partitë politike, në proceset e tenderimit dhe punësimit në sektorin publik</li> <li>• Mosshfrytëzimi i burimeve natyrore si potencial ekonomik</li> <li>• Interesi i dobët për start-up dhe sipërmarrje, për shkak të mungesës së stafit të ri</li> <li>• Mungesa e stafit të punës në sektor të caktuar, veçanërisht në industrinë hotelierike, ndërtimtari</li> <li>• Mungesa e një strategjie të përcaktuar qartë për zhvillimin e turizmit dhe zhvillimit rural</li> <li>• Migrimi fshat-qytet, i cili redukton mundësitë për zhvillim rural dhe rrit shpopullimin</li> <li>• Kujdesi sistematik dhe fonde të pamjaftueshme për promovimin e trashëgimisë kulturore-historike</li> </ul>



<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kushtet klimatike të favorshme për kultura të caktuara bujqësore, veçanërisht hortikulturës</li> <li>• Subjekte aktive nga sektori i biznesit: Automobilistikë, Ndërtimtari, Tregti dhe prodhim etj.</li> <li>• Vende natyrore me kushte për zhvillimin e turizmit alternativ – Bistra, Dardha, Knezhino, Arljec, Ljigata, etj.(mont bajk, shetitje në mal, gjueti, peshkim. Etj.)</li> </ul>	
<b>MUNDËSITË</b>	<b>KËRCËNIMET</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kapitali i mërgimtarëve dhe interesimi i tyre për investime në komunë</li> <li>• Investimet në TIRZ, në zonat që nuk kanë ende investitorë.</li> <li>• Shfrytëzimi i burimeve natyrore për shkak të trendit të investimeve dhe kërkesave për ushqim të shëndetshëm (kërpudha, fruta pylli), gjueti dhe peshkim.</li> <li>• Investimet në monumente dhe trashëgimi kulturore dhe historike nga aspekti i turizmit dhe rritja e të ardhurave</li> <li>• Programe të hapura, fonde të BE-së, ndërkombëtare, programe IPA ndërkufitare, IPARD programi, programe për zhvillim rural, startup, etj.</li> <li>• Programi për mbështetjen e „msp,, dhe stafit gjatë transformimit të TEC Oslomej për mënyra alternative të prodhimit të energjisë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrupsioni i lartë dhe procedurat burokratike krahasuar me regjione apo komuna të tjera përsa i përket investimeve</li> <li>• Zhvillim negativ demografik, migrim i stafit të ri dhe profesional për shkak të kushteve të jetesës dhe egzistencës.</li> <li>• Menaxhimi jo adekuat i burimeve natyrore në drejtim të shfrytëzimit efektiv të tyre.</li> <li>• Kriza ekonomike dhe energjitike në nivel shtetëror me reflektim mbi komunitetin</li> <li>• Arsimim profesional joadekuat, sipas nevojave të tregut të punës dhe ekonomisë lokale.</li> <li>• Transformimi i TEC Oslomej në burime alternative të prodhimit të energjisë, pa zbutur paralelisht pasojat e saj (punësimi dhe financat të cilët ndikojnë komunitetin).</li> </ul>

## **6.Vizion dhe qëllime strategjike**

### **Vizioni:**

Kërçova, qytet ekologjikisht i pastër, i zhvilluar ekonomikisht dhe infrastrukturor, vend atraktiv turistik me vlera multikulturore dhe menaxhim të qëndrueshëm të resurseve ekzistuese.

### **Qëllimet strategjike:**

QS 1 - Të ndikohet në përmirësimin e zhvillimit infrastrukturor dhe mjedisit nëpërmjet rindërtimit të ekzistuesit dhe investimit në një të riu.

QS 2 – Të ndikohet në rritjen e ekonomisë në komunë duke krijuar një klimë të favorshme ekonomike dhe ambient biznesi.

QS 3 - Të ndikohet në rritjen e të ardhurave në komunë nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit të mundësive dhe potencialeve turistike

## **7. Plani aksionar**

Për arritjen e qëllimeve strategjike të komunës së Kërçovës janë identifikuar këto aktivitete të dhëna në tabelën e mëposhtme.

Secili prej aktiviteteve shoqërohet me një qëllim strategjik përkatës për të cilin kontribuon (kolona 2), si dhe me bllokun përkatës të ndërtimit, sipas metodologjisë së strategjisë së ZHEL-it (kolona 1). Gjithashtu, në planin aksionar janë përfshirë aktivitetet e parashikuara, kohëzgjatjen e pritshme të tyre, rezultatet e pritura (kolona 7) dhe treguesit për matjen e aktiviteteve të realizuara, përkatësisht treguesit e monitorimit (kolona 8).

Bloqet ndërtuese	Qëllimet kryesore (strategjike)	Aktivitete/projekt ide	Kohëzgjatja (fillim/mbarim)	Partnerë të përfshirë	Hargjime të parapara	Rezultate (direkte (outputs))	Indikatorë monitorues
1. Toka dhe infrastruktura 2. Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi lokal 3. Mjedisi i biznesit, transparencja dhe administrimi pa korrupsion	<b>1. Përmirësimi i zhvillimit infrastrukturor dhe mjedisit</b>	1. Vendosja e fotovoltaikeve në 7 shkollat dhe objektivisht komuna me kapacitet 250 kw	2024-2027	Komuna, Qeveria. Ministritë/institucionet kompetente.  Donatorë vendas dhe të huaj	15.300.000	Instalimi i fotovoltaikeve në 7 objektet e shkollave dhe institucioneve  Kursimi i energjisë elektrike, mbrojtja e mjedisit, reduktimi i emetimit të gazrave të dëmshëm	Numri i kontratave të lidhura për furnizimin e fotovoltaikeve  Procesverbali i pranimit teknik të furnizimit  Procesverbali i vënies në punë të fotovoltaikeve në objekte
		2. Krijimi i një baze informacioni për ndërtesat dhe një studim për nevojat e efijencës së energjisë	2024- 2025	Komuna e Kërçovës, Njësia e biznesit, sektori i ndërtimit	306.000  1.836.000	Përpunuar në bazë të ndërtesave me nevoja për efijencë energjetike  Qasje deri te informacioni mbi mundësitë e financimit në efijencën e energjisë	Numri i vizitave në bazën e informacionit  Numri i projekteve të përfunduara. Numri i marrëveshjeve të lidhura për subvencionim
		3. Rikonstruksioni i fasadës së 1 objekti kolektiv në zonën qendrore të qytetit - Projekt  "Shtëpi me efikasitet energjetik"	2025-2027	Komuna e Kërçovës, Bankat komerciale, Njësia e biznesit, Donatorët, Programi i Tranzicionit të Gjellbër		Përmirësimi i efijencës energjetike të 1 objekti banimi kolektiv  Kursimi i energjisë elektrike	Numri i linjave të kreditit të përdorura nga qiramarrësit në ndërtesa  Kontrata e lidhur me komunitetin e qiramarrësve/person juridik  Pagesa e mjeteve nga buxheti i komunës/banka komercijale

<p>1. Bashkëpunimi dhe ndërlidhja Lokale</p> <p>2. Mjedisi i biznesit, transparencja dhe administrimi pa korrupsion</p> <p>2. Pozicionimi dhe marketingu i jashtëm</p>	<p><b>2. Rritja ekonomike në komunë përmes krijimit të një klime të favorshme biznesi dhe mjedisi afarist.</b></p>	<p>1. Asfaltimi i rrugëve -4556 m dhe vendosja e ndriçimit rrugor -25 shtylla në Zonën Industriale të Ekonomisë së Vogël IVANIDOL.</p>	2024-2026	<p>Komuna e Kërçovës, Qeveria e RMV</p> <p>Komuna e Kërçovës, TIRZ e Kërçovës. Agjencia e punësimit, ministritë kompetente, bankat dhe donatorët</p>	70.000.000	<p>Rruge aksesi te asfaltuara ne hallat ne zonen per biznesin e vogel IVANIDOL, instalimi i ndricimit rrugor i ne zone</p> <p>Staf i trajnuar i gatshëm për të punuar sipas nevojave të ekonomisë lokale,</p>	<p>Kontratë e lidhur me realizuesin e punimeve/asfaltimit, instalimit të ndriçimit rrugor</p> <p>Numri i kilometrave të shtruar/Numri i shtyllave të reja të ndriçimit rrugor të instaluar</p> <p>Numri i punësimeve të reja në kompanitë ekzistuese, numri i stafit të trajnuar, numri i nevojave të deklaruar për punë nga „MSP„-të, numri i punëkërkuësve aktivë dhe pasivë të regjistruar.</p>
		<p>2. Organizimi i trajnimeve për kualifikim/rikualifikim sipas nevojave të tregut të punës si dhe për përshtatje pas zbatimit të Tranzicionit të Gjellbër të REC Oslomej.</p>	2024-2028		1.000.000		
		<p>3. Organizimi i Panairit për Karrierë dhe Forum Biznesi, Promovimi i kushteve për investim dhe ndërlidhja e investitorëve"</p>	2024-2028	<p>Komuna dhe Dhoma Rajonale e Biznesit</p>	367.200	<p>Panair dhe Forum i organizuar, çdo vit</p>	<p>Numri i kompanive të përfshira, numri i kërkesës, numri i pjesëmarrësve.</p>

		4. Krijimi i një Fondi komunal për mbështetjen e startupeve të reja dhe punësimin në kompanitë ekzistuese	2024-2028	Komuna e Kërçovës,  Sektori i biznesit, donator potencial.	4.284.000	Krijimi i fondit për bashkimin e burimeve financiare të komunës dhe komunitetit të biznesit, Qasje e financave për fillimin e një biznesi, Ndikim në reduktimin e daljes së stafit të ri, ndikimi në reduktimin e migrimit dhe shpopullimit.	Numri i punonjësve të rinj përmes start up programeve  Numri i kompanive të sapohapura në baza vjetore  Numri i kërkesave për vende të reja pune në firmat ekzistuese
		5. Zhvillimi i një mjeti për mbledhjen e fondeve dhe vënia në përdorim e tij	2024-2025	Komuna e Kërçovës  IT Sektori, Njësia ZHEL	120.000	Zhvillimi i një mjeti për mbledhjen e donacioneve për zbatimin e projekteve  Një komunë më transparente në realizimin e projekteve	Numri i klikimeve në web faqen e internetit të komunës  Numri i donatorëve që dhuruan mjete  Numri i projekteve të realizuara
		6. Zhvillimi i infrastrukturës dhe shërbimeve dixhitale	2024-2026	Komuna e Kërçovës	600.000	Zhvillimi i një platforme për shërbime publike dixhitale për sektorin e biznesit, ngritja e pikave të aksesit falas në internet në mjedise dhe ambiente publike, zhvillimi i një aplikacioni celulari për shërbime specifike (biznes, social, etj.)	Numri i shërbimeve dixhitale, Numri i pikave me akses falas në internet.  Numri i përdoruesve të shërbimeve publike dixhitale.

<p>1. Локална соработка и Вмрежување</p> <p>2. Бизнес опкружување, транспарентност и администрација без корупција</p> <p>2. Надворешно позиционирање и маркетинг</p>	<p><b>3. Зголемени приходи во општината преку развој и промоцијата на туристичките можности и потенцијали.</b></p>	<p>1. Изработка на маркетинг план за промоција на постојните функционални туристички капацитети</p>	2024-2025	Општина Кичево	918.000	Изработен план за промоција на туристичките капацитети на општината	Усвоен план од страна на Советот
		<p>2. Ставање во функција на Мултимедијалниот Центар и Ресторанот на Китино Кале</p>	2024-2028	Општина Кичево, Бизнес сектор	120.000	Создаден функционален Центар за мултимедијални настани и отворен ресторан преку концесија/ЈПП	Број на одржани семинари, работилници и презентации, број на домашни и надворешни посетители, број на директни и индиректни вработувања  Договор за издавање на ресторанот под концесија/ЈПП
		<p>3. Организација на нови културни манифестации преку креирање на Проект - Кичевско културно лето</p>	2024-2028	Општина Кичево, ЛЕР, Министерство за култура, Национални институции од културата, Граѓански организации, Меѓународни фондови	1.836.000	Воспоставена манифестација- Кичевско Културно лето  Зголемување на културната понуда во градот	Број на организирани настани  Број на посетители/излагачи  Број на ноќевања во сместувачки и угостителски капацитети



## 1. Финансиска рама

Во наредната табела подолу се идентификувани можните извори на финансирање на секоја од претходно наведените активности. Нивното финансирање ќе биде со средства од Општина Кичево, Влада на РСМ, национални програми, но и со европски програми и фондови од странство.

Активности	Предвидени трошоци	Извори на финансирање					Непокриени трошоци	Забелешки
		Национални програми	Локален буџет	Приватен сектор	Донатори	Други		
1.1 Поставување на фотоволтаици на 7 училишта и објективно општината со капацитет од 250 kw	15.300.000	12.240.000	3.060.000					Со ко-финансирање (80%) од националните програми и 20% од локален буџет
1.2 Изработка на инфо база на згради и студија за потребите од енергетска ефикасност	306.000		306.000					Средства предвидени од локалниот буџет
1.3 Реконструкција на фасада на 1 колективна зграда во централно градско подрачје-Проект „Енергетски ефикасни домови“	1.836.000		1.468.800		367.200			Ко-финансирање 80% од локален буџет и 20% од донатори/куќен совет или др.
2.1 Асфалтирање на улиците - 4556 м и поставување на улично осветлување -25 бандери во Индустриска зона за мало стопанство ИВАНИДОЛ	70.000.000	42.000.000	28.000.000					Со кофинансирање на Влада на РСМ од 60% и локален буџет од 40%

2. 2 Организирање на обуки за преквалификаци/доквалификација според потребите на пазарот на трудот како и за адаптација по спроведување на Зелена транзиција на РЕК Осломеј	1.000.000	500.000	500.000					Кофинансирање од 50% на национални програми и 50% од локалниот буџет
2.3 Организација на Саем за кариера и Бизнис форум Промоција на условите за инвестирање и вмрежување на инвеститори“	367.200		367.200					Локален буџет
2.4 Креирање на општински Фонд за поддршка за нови стартапи и вработувања во постојни фирми	4.284.000		2.570.400	1.713.600				Од локален буџет 60% и од бизнис сектор 40%
2.5 Изработка на алатка за fundrising и нејзино ставање во употреба	120.000		120.000					Локален буџет
2.6 Развојна дигитална инфраструктура и дигитални услуги	600.000		600.000					Локален буџет
3.1 Организација на традиционални и нови културни манифестации	918.000		918.000					Локален буџет
3.2. Ставање во функција на Мултимедијалниот Центар и Ресторанот на Китино Кале	120.000		120.000					Локален буџет
3.3. Организација на нови културни манифестации преку креирање на Проект - Кичевско културно лето	1.836.000	734.400	1.101.600					Локален буџет од 60%, додека 40% од Национални програми
<b>Вкупно</b>	<b>96.687.200</b>	<b>55.474.000</b>	<b>39.132.000</b>	<b>1.713.600</b>	<b>367.200</b>			

Изработиле:

**Дарко Белевски** – Раководител на Одделение за Локален Економски Развој  
на општина Кичево

Емаил: [darkobelevski@yahoo.com](mailto:darkobelevski@yahoo.com)

Тел. 075-212-526

**Дејан Илиоски** – Претседател на Локален Економски-социјален Совет на  
општина Кичево [www.less.mk](http://www.less.mk)

[www.kicevo.gov.mk](http://www.kicevo.gov.mk)